



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1280/1 Prot.

Tiranë më 27.07. 2021

V E N D I M

Nr. 36, datë 27.07.2021

“PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË NDRYSHIMIT TË EMRIT TË NJËSISË KRYESORE SI DHE NDRYSHIMIN E EMRIT TË DISA NJËSIVE BAZË NË INSTITUTIN E GJEOSHKENCAVE, ENERGISJË, UJIT DHE MJEDISIT”.

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin Nr. 1, datë 08.06.2021, të Asamblesë së Personelit Akademik të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, “Për propozim për ndryshimin e emrit të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit”, në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike të Universitetit Politeknik të Tiranës Nr. 1011/1 Prot., datë 27.07.2021, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.07.2021,

VENDOSI:

Miratimin e propozimit të ndryshimit të emrit të njësisë kryesore dhe të disa njësive bazë në IGJEUM si më poshtë vijon:

1. Emërtimi i njësisë kryesore Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit bëhet Instituti i Gjeoshkencave.
2. Emërtimi i Departamentit të Klimës dhe Mjedisit bëhet Departamenti i Meteorologjisë.
3. Emërtimi i Departamentit të Ekonomisë Ujore dhe Energjive të Rinovueshme bëhet Departamenti i Hidrologjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Nr.4, Tiranë.

Tel/Fax: +355 4 2227914,

web: www.upt.al